



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal  
 Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave  
 Ministry of Local Government Administration

<b>Për:</b>	<b>Agron Kuçi, Kryetar i Komunës së Junikut</b> <b>Faik Tofaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Junikut</b>	
<b>Cc:</b>	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë	
<b>Përmes:</b>	Mirjana Jevtić, <b>Ministre e Administrimit të Pushtetit Lokal</b> Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme	
<b>Nga:</b>	Besim Myrtezani, U.D. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave, MAPL	Datë: 08/02/2017 Nr.020-272
<b>Lënda:</b>	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të komunës së Junikut	
<b>Lloji i aktit:</b>	Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,  
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës (QRK) Nr.01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr.02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim Nr.02/116 për datën e mbajtjes së mbledhjeve të rregullta të Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2017
I miratuar më datë: 31.01.2017
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 06.02.2017

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.





Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal  
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave  
Ministry of Local Government Administration

Za:	Agron Kuçi, gradonačelnik Opštine Junik Faik Tofaj, predsedavajući Skupštine opštine Junik	
Kopija:	Jedinica za upravljanje dokumentima u MALS-u Jedinica za upravljanje dokumentima u opštini	
Preko:	Mirjana Jevtić, ministarka MALS-a Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka MALS-a	
Od:	Besim Murtezani, v.d. rukovodioca pravnog odeljenja i monitorisanje opština, MALS	Dana: 08.02.2017. Br. 020-272
Predmet:	Potvrda zakonitosti akta opštine Junik	
Vrsta akta:	Odluka Skupštine opštine Junik	

Poštovani gradonačelnice,  
Poštovani predsedavajući,

U saglasnosti sa Uredbom Vlade Republike Kosova br.01/2016 za administrativno razmatranje opštinskih akata, i na osnovu zakonskih nadležnosti ministarstva, određenim osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br.02/2011 o poljima administrativne odgovornosti Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenju za pravna pitanja i monitorisanje opština Ministarstva administracije lokalne samouprave dostavljen je sledeći opštinski akt za obavezno razmatranje zakonitosti, onako kako je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi:

Odluka br.02/116 za raspored održavanja redovnih sednica Skupštine opštine Junik, za 2017. godinu.
Usvojena dana: 31.01.2017.
Dostavljena MALS-u na razmatranje dana: 06.02.2017.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave nakon razmatranja sadržaja gore navedenog opštinskog akta, procenjuje da je isti **u skladu sa odredbama zakonodavstva na snazi** i kao takav može proizvesti punopravni učinak. Ministarstvo administracije lokalne samouprave stoji na raspolaganju opštini za bilo kakvo dodatno objašnjenje u vezi sa ovom procenom.



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
 REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA  
**KOMUNA E JUNIKUT**  
 MUNICIPALITY OF JUNIK - OPŠTINA JUNIK



Republika e Kosovës;  
 Kuvendi i Komunës së Junikut;  
 Numër: 02/116;  
 Datë: 31.01.2017.

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA		
Komuna Junik - Opština Junik		
Numër	Nr.faq	Data
2-40/332	2	31.01.2017

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 05/11-040, GZRK numër 28/2008), nenit 21 paragrafi 21.1 pika h) të Statutit të Komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26), **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 31.01.2017 nxjerrë:

**VENDIM**

për

datën e mbajtjes së mbledhjeve të rregullta të Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2017

I. Me këtë vendim përcaktohet data e mbajtjes së mbledhjeve të rregullta të Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2017.

II. Datat e mbajtjes së mbledhjeve të rregullta të Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2017 janë si në vijim:

- II.1. Janar - 31.01.2017, e martë
- II.2. Shkurt - 24.02.2017, e premte;
- II.3. Mars - 31.03.2017, e premte;
- II.4. Prill - 28.04.2017, e premte;
- II.5. Maj - 26.05.2017, e premte;
- II.6. Qershor - 28.06.2017, e mërkurë;
- II.7. Korrik - 28.07.2017, e premte;
- II.8. Gusht - 31.08.2017, e enjte;
- II.9. Shtator - 22.09.2017, e premte;
- II.10. Tetor - 27.10.2017, e premte;
- II.11. Nëntor - 24.11.2017, e premte;
- II.12. Dhjetor - 29.12.2017, e premte.

HYRESE ULAZNA-INCORPORATION	
MINISTRIJA E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL Ministry of Local Government Administration	
Data 06.02.2017	
Data	
Organizimi	27
Organizimi	020-272

III. Seancat solenne të Kuvendit të Komunës së Junikut do të mbahen me: 17 shkurt 2017 (Dita e Pavarësisë së Republikës së Kosovës); 24 maj 2017 (15 vjetori i Kuvendit të Junikut) dhe 13 qershor 2017 (Dita e Çlirimit të Junikut)

IV. Nëse datat e përcaktuara sipas nenit II. të këtij vendimi përkojnë me ndonjë festë ose datë tjetër që nuk punohet, mbledhja do të mbahet ndonjë ditë tjetër pune.

V. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen të gjitha dispozitat ligjore me anën e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar deri më tash.

Adresa:  
 Tel.: +386 (0) 49 760 270  
<http://rks.gov.net/junik>

VI. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. MAPL;
2. Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Junikut;
3. Kryetari i Komunës së Junikut;
4. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut; dhe
5. Arkivi i Komunës së Junikut.

Kuvendi i Komunës së Junikut

Faik TOFAJ

  
Kryesues